

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot, në cilësinë e relatores për projektligjin “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””, dua të theksoj nevojën e miratimit të këtij projektligji, duke marrë parasysh edhe propozimet apo sugjerimet e grupeve të deputetëve pranë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, por edhe propozimet e agjencive të administrimit kolektiv. Ky ligj luan një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës në vendin tonë, sepse vjen në ndihmë të komuniteteve të krijuesve, si dhe siguron më shumë drejtësi dhe transparencë për ta, por kryesisht vjen si një domosdoshmëri për të mbrojtur më tepër të drejtat e autorit. Qëllimi i projektligjit është përafrimi i tij me direktivat e Bashkimit Europian, si dhe rregullimi i mënyrës së funksionimit të agjencive të administrimit kolektiv për t’u dhënë zgjidhje problematikave ekzistuese.

Gjatë zbatimit të ligjit aktual janë hasur disa problematika, ndër të cilat do të veçoja: Së pari, qarkullimi i veprave, autori i të cilave nuk mund të identifikohet ose nuk mund të gjendet. Në projektligj këto vepra emërtohen si vepra pa autor dhe mund të jenë libra, artikuj gazetash, revistash, vepra kinematografike ose vepra të tjera vizuale e të tjera. Për këto vepra mungojnë të dhënat statistikore dhe nuk ka rregullim ligjor për të drejtat e përdorimit të tyre nga institucionet kompetente, siç mund të jenë bibliotekat publike, institucionet arsimore, muzetë, arkivat, transmetuesit publikë e të tjerë. Nga ana tjetër, ekziston nevoja për përdorimin e tyre nga këto institucione, që më pas duhet t’ia vënë në dispozicion publikut. Së dyti, numri i librave dhe materialeve të ndryshme, të printuara me formate të përshtatshme për persona të verbër apo me aftësi të kufizuara në shikim, është i vogël, ndërkohë që nevoja për përdorimin e tyre është më e madhe. Së treti, janë evidentuar problematika për funksionimin e agjencive të administrimit kolektiv, konflikti i interesit dhe parregullsitë për mënyrën dhe përqindjen e ndarjes së shpërblimeve të mbledhura, sepse dispozitat ligjore ekzistuese lënë vend për keqinterpretime. Cilat janë risitë e këtij projektligji?

Së pari, parashikohen dispozita për dhënien e statusit “Vepra pa autor”. Së dyti, mbështeten persona të verbër apo me aftësi të kufizuara në shikim për t’u pajisur me kopje të veprave të autorëve të ndryshëm në format e përshtatshme për ta. Së treti, saktësohen dispozitat lidhur me funksionimin e agjencive të administrimit kolektiv. Konkretisht për sa u takon dispozitave për dhënien e statusit të veprave pa autor sillen disa risi, siç janë: rregullimi i mënyrave të përdorimit të veprave pa autor, si dhe përcaktimi i institucioneve të lejuara për përdorimin e këtyre veprave, siç janë: bibliotekat publike, institucionet arsimore, muzetë, arkivat, si dhe transmetuesit publikë. Vendoset detyrimi për kryerjen e kërkimit shterues për çdo vepër përpara përdorimit të saj. Kërkimi bëhet te burimet e përshtatshme për

kategorinë përkatëse të veprave. Jepet e drejta për riprodhimin e veprave pa autor nga institucionet për qëllime të digjitalizimit, si dhe vendosjen e tyre në dispozicion të publikut, por kur këto janë të indeksuara, kataloguara, ruajtura dhe restauruara.

Gjatë përdorimit të veprave pa autor, institucionet mund të përfitojnë të ardhura vetëm për qëllime të mbulimit të kostove të digjitalizimit dhe vendosjes së tyre në dispozicion të publikut. Gjithashtu, këto institucione janë të lira për të lidhur kontrata, ku lejohen edhe kontrata e partneritetit publikprivat. Njihet, gjithashtu, e drejta e kompensimit për autorin ose bashkautorin e veprës për përafrimin e statusit të veprës pa autor. Ky kompensim jepet nga institucionet që e kanë përdorur veprën dhe shuma e kompensimit përcaktohet sipas disa kategorive që përcaktohen si vepra pa autor, si dhe krijohet një bazë të dhënash për kërkimin online për veprat pa autor. Mbështetja e personave të verbër apo me aftësi të kufizuar në shikim parashikohet dhe jepet nëpërmjet dhënies së personave fizikë ose juridikë të së drejtës për të riprodhuar, botuar apo përshtatur vepra të autorëve të ndryshëm, pa autorizimin e tyre, me qëllim për t'ua përcjellë personave të verbër apo me aftësi të kufizuar në shikim.

Këto subjekte mund e duhet të kenë përfitim ekonomik dhe duhet të plotësojnë disa detyrime të përcaktuara në projektligj. Bëhet i lehtësueshëm identifikimi, në bashkëpunim me subjektet e autorizuara publike dhe private, i personave të verbër apo me aftësi të kufizuar në shikim. Parandalohet shpërndarja dhe vendosja në dispozicion e veprave të autorëve të ndryshëm në mënyrë të paautorizuar. Përfshihen nga përfitimet e të drejtës së autorit rastet e riprodhimit, shpërndarjes, vënies në dispozicion të publikut dhe huadhënies së veprës të përshtatshme për personat e verbër dhe atyre me kufizime në shikim. Gjithashtu, saktësohen dispozitat lidhur me funksionimin e agjencive të administrimit kolektiv për sa i përket përfaqësimit të administrimit të të drejtave nga agjencitë e administrimit kolektiv, shmangien e konfliktit të interesit, si dhe mënyrën e përqindjes së ndarjes së të ardhurave nga pagesa e tarifës për të drejtën e autorit. Në bazë të funksionimit të sportelit unik të administrimit të të drejtave të autorit, "SUADA", gjatë monitorimit të tyre është konstatuar se efikasiteti në mbledhjen e të ardhurave dhe dhënien e shpërblimeve ka qenë i ulët, ndërkohë që kostot e administrimit kanë qenë shumë të larta.

Ky projektligj parashikon që agjencitë e administrimit kolektiv të autorizohen për mbledhjen e shpërblimit për të drejtën e autorit jo vetëm për anëtarët e tyre, por edhe për përmbajtësit e të drejtave që nuk janë anëtarë të tyre, të cilët japin pëlqimin me shkrim dhe paraqesin lista të plota të titujve dhe të veprave që do të administrojnë. Projektligji parashikon që të mos ketë një agjenci drejtuese në krye të sportelit unik, siç është aktualisht, por në një mënyrë që vendimmarrja të jetë e balancuar, për të siguruar shpërndarjen e drejtë të shpërblimit mes anëtarëve. Projektligji përmirësohet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes së drejtorit ekzekutiv në mënyrë të pavarur nga sporteli unik. Një risi tjetër që vlen të përmendet është përmirësimi i procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencave të agjencive të administrimit kolektiv, duke përcaktuar kushtet që çojnë në marrjen e këtyre vendimmarrjeve. Efektet financiare që lidhen me këtë projektligj përbëhen nga shpenzimet për krijimin e regjistrimit elektronik të veprave pa autorë, në vlerën 16 milionë lekë dhe nga shpenzimet për mirëmbajtjen e tij në vlerën 3,2 milionë lekë deri në vitin 2030.

Shpenzimet totale të projektit deri në vitin 2030 janë rreth 45 milionë lekë. Këto shpenzime janë parashikuar të mbulohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, ndërsa kërkimi shterues do të kryhet nga nëpunësit e strukturave ekzistuese të institucioneve kompetente dhe nuk do të sjellë asnjë shpenzim për buxhetin e shtetit. Në lidhje me agjencitë e shpenzimit kolektiv, duke iu referuar të dhënave të tyre sa për statistikë, siç u cituan edhe nga ministrja, gjatë periudhës 2-vjeçare numri i autorëve që kanë përfituar është 134, ndërsa të ardhurat që ka përfituar çdo autor janë rreth 68 mijë lekë. Shpenzimet për 2 vjet përlllogariten në vlerën 9,1 milionë lekë, ku mesatarisht i bie 4,6 milionë lekë në vit. Këto shpenzime nuk përballohen nga buxheti i shtetit, por nga të ardhurat e agjencive të administrimit kolektiv, për të cilën u bë edhe debati në Komisionin e Edukimit, por të gjithë ramë dakord që ta miratojmë këtë projektligj. Pra, ashtu siç e miratuam në komision, ju ftoj ta miratojmë përsëri.